URDHËR
Nr. 499, datë 10.9.2019

PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS TË KOMISIONIT TË PËRGJITHSHËM TË PESHKIMIT PËR MESDHEUN NR. GFCM/41/2017/6, PËR APLIKIMIN E NUMRIT IMO

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 3 dhe 5, të ligjit nr. 9093, datë 3.7.2003 "Për ratifikimin e Marrëveshjes për Krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun", ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pajisjen me numër IMO, të të gjitha anijeve shqiptare të peshkimit mbi 24 m, brenda datës 30 shtator 2019.
2. Anijet, që brenda afatit sipërcituar, nuk janë pajisur me numër IMO, nuk do të lejohen të ushtrojnë aktivitetin e peshkimit.
3. Aplikimi është falas dhe bëhet në faqen elektronike të IMO https://imonumbers.ihs.com/
4. Pika 1 e urdhrit nuk zbatohet për anijet me strukturë të drunjtë, të cilat mund të aplikojnë vullnetarisht për pajisjen me numër IMO.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi